



**REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA - MUNICIPALITY**  
**HANI I ELEZIT**



---

**Nr. 04/10801/2023**

**Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt  
buxhetin e komunës për vitin 2024**

**Dhjetor, 2023**

## Hyrje

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit është një plan fiskal që përcakton të hyrat dhe shpenzimet e parashikuara për të udhëhequr shërbimet dhe politikat që zbatohen gjatë vitit fiskal 2024. Ai përcakton bazat për ato që do të jenë qëllimet dhe arritjet e komunitetit tonë.

Buxheti i propozuar do të vazhdojë të arrijë prioritetet afatmesme të komunës siç janë aprovuar në qershor 2023 me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026. Ju do të shihni se këtyre prioriteteve do t'i referohem përgjatë këtij dokumenti, i cili është hartuar nga grupi punues si dhe kryesisht reflekton kërkesat e qytetarëve/eve, siç paraqiten gjatë dëgjimeve publike buxhetore, të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi komunal.

Buxheti i vitit 2024 pasqyron përpjekjen tonë të vazhdueshme për të ofruar shërbime arsimore cilësore në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm; shërbime shëndetësore, si dhe zhvillim të mëtutjeshëm të infrastrukturës që do të japë kontribut drejt zhvillimit të komunës së Hanit të Elezit. Për t'i zbatuar prioritetet e mësipërme, buxheti për vitin fiskal 2024 ka përfshirë gamën e plotë të operacioneve dhe programeve komunale të cilat i përfshijnë të mëposhtmet:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata dhe Personeli,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxheti dhe Financat,
5. Shërbimet Publike, Emergjencat dhe Mbrojtja Civile,
6. Zyra për Komunitete dhe Kthim,
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
8. Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi,
9. Planifikimi Urban dhe Inspeksioni,
10. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
11. Arsimi dhe Shkenca dhe
12. Kultura, Rinia dhe Sporti.

Programet e komunës vazhdojnë ta pasqyrojnë qëllimin tonë për ta përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve/eve tanë/tona, shoqëruar me një menaxhim të shëndoshë dhe financiar.

Gjatë fazave të hershme të planifikimit të buxhetit kemi formuar grupin punues për hartimin e buxhetit si dhe kemi bërë planin e dëgjimeve buxhetore. Fokusi ynë ka qenë i përqëndruar të arrijmë tek çdo qytetarë/e pa dallim. Rrjedhimisht, kemi mbajtur dëgjimeve buxhetore me grupe të ndryshme të interesit, të cilat i gjeni të listuara në vijim.

## Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2024

Fillimisht, nga Kryetari i Komunës u themelua grupi punues për hartimin e buxhetit si dhe grupi punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Në planin e dëgjimeve buxhetore është specifikuar çdo detaj, duke filluar nga:

1. Aktivitetet para-përgatitore,
2. Aktivitetet Kryesore,
3. Masat që duhet të ndërmerren,
4. Stafi përgjegjës dhe stafi përkrahës/suportues,
5. Korniza kohore (Vendi dhe koha) dhe
6. Veprimet e ndërmarra.

Aktivitetet të cilat janë ndërmarrë për organizimin e dëgjimeve buxhetore, janë si vijon:

- Takimet e Grupit punues përpara caktimit të datave të dëgjimeve buxhetore,
- Diskutimet e Grupit punues rreth kufijve fillestar dhe final buxhetor dhe shpërndarjen e tyre në Programe dhe kategori të ndryshme buxhetore,
- Hartimi i një Draft Buxheti për të pasur banorët/et një pasqyrë rreth burimeve të financimit të aprovuara nga MFPT,
- Caktimi i datave të dëgjimeve buxhetore nëpër lokacione të ndryshme,
- Publikimi i kalendarit të dëgjimeve buxhetore në afatin e përcaktuar në ueb faqe të Komunës si dhe në faqen zyrtare të rrjetit social Facebook,
- Ftesat personale tek Target Grupet,
- Rikujtimi për dëgjimet buxhetore në ueb faqen e Komunës dhe në faqen zyrtare në Facebook,
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore sipas kalendarit të dëgjimeve buxhetore,
- Mbajtja e procesverbalit,
- Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave të banorëve/eve nga Grupi Punues,
- Dërgimi i kërkesave të banorëve/eve .

Paraqitja tabelare e dëgjimeve buxhetore

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takime i drejtpërdrejtë në qytet me Shoqatën "HandiKos"	14.08.2023 / 1 orë e 5 min	23 pjesëmarrës/e, 9 gra dhe 14 burra	5 persona
2. Takim i drejtpërdrejtë në qytet me Gratë e Komunës	14.08.2023 / 1 orë	17 pjesëmarrës/e, 13 gra dhe 4 burra	3
3. Takim i drejtpërdrejtë në qytet me OJQ-të dhe Shoqatat e Komunës	15.08.2023 / 1 orë	20 pjesëmarrës/e, 8 gra dhe 12 burra	4
4. Takim i drejtpërdrejtë në qytet me Bizneset e Komunës	15.08.2023 / 15 min	15 pjesëmarrës/e, 7 gra dhe 8 burra	/
5. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Gorancë	16.08.2023 / 1 orë e 30 min	38 pjesëmarrës/e, 4 gra dhe 34 burra	5
6. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Paldenicë	16.08.2023 / 1 orë	14 pjesëmarrës/e 3 gra dhe 11 burra	3
7. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Krivenik	17.08.2023 / 1 orë	9 pjesëmarrës/e 4 gra dhe 5 burra	1
8. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Seçishtë	17.08.2023 / 40 min	10 pjesëmarrës/e 4 gra dhe 6 burra	1
9. Publikimi në ueb faqe / platforma elektronike	15 ditë		21 persona

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara

	<b>Kërkesat/Sugjerimet/ Komentet</b>	<b>Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim</b>	<b>Statusi i kërkesës</b>	<b>Arsyetimi</b>
Buxheti i vitit 2024 dhe parashkimi për vitet 2025-2026	1. Qasja nëpër qytet, pjerrina nëpër trotuare dhe qasje tek veranda për persona me aftësi të kufizuara,	<b>Nerxhivane Berisha</b> – Anëtare e Shoqatës “Handikos”	E pranuar	Do të shikojmë konkretisht ku duhet të ndërhyjmë si për pjerrinat nëpër trotuare si dhe për qasje në bunkerat
	2. Dëmtimi i protezës së një anëtari të shoqatës, kërkesë për t’iu drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, për t’ia dhënë një të re?	<b>Nerxhivane Berisha</b> – Anëtare e Shoqatës “Handikos”	E pranuar	Për realizimin e kësaj kërkesë do të ndihmojmë banorin në fjalë për të bërë kërkesë në Ministrinë
	3. Sigurimi i barnave esenciale,	<b>Zyrafete Ramuka</b> - Anëtare e Shoqatës “Handikos”	Pjesërisht e pranuar	Sigurimi i barnave esenciale është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë por ka gjasa që një listë e barnave të sigurohet nga Jetimat e Ballkanit por përkohësisht.
	4. Propozim për rritjen e subvencionit për Shoqatën “Handikos”	<b>Naser Laçi</b> – Zyrtar Komunal	Pjesërisht e pranuar	Kjo do të mvaret nga numri i shoqatave/OJQ-të që do të aplikojnë dhe me çfarë projektesh do të jenë aplikimet e të njejtave
	5. Kërkesë për sigurimin e transportit të Shoqatës	<b>Hamim Kaloshi</b> – Anëtar i Shoqatës “Handikos”	E pranuar	Komuna ka zhvilluar procedura për rehabilitimin e anëtarëve të Handikos vite

	<p>nëpër qendra rehabilituese si dhe subvencionimin e atyre anëtarëve të cilët nuk kanë mundësi ta financojnë vetë.</p> <p>6. Kërkesë për vendosjen e një semafori te udhëkryqi te marketi Besa</p> <p>7. Mundësi punësimi për persona me aftësi të kufizuara</p> <p>8. A do të bëhet me pagesë uji i pijes dhe a do mundet të ulet pagesa e ujit të pijes?</p>	<p><b>Hamim Kaloshi</b> – Anëtar i Shoqatës “Handikos”</p> <p><b>Avni Bajramaliu</b> - Anëtar i Shoqatës “Handikos”</p> <p><b>Nerxhivane Berisha</b> - Anëtare e Shoqatës “Handikos”</p>	<p>Pjesërisht e pranuar</p> <p>Pjesërisht e pranuar</p> <p>E pranuar</p>	<p>rradhazi, ku është përfshirë edhe transporti.</p> <p>Do të bëjmë kërkesa te Ministrinë e Linjës</p> <p>Çështjen e punësimit do ta marrim si rekomandim dhe do t’i shohim cilat janë mundësitë</p> <p>Bifurkacioni është përgjegjës dhe kompetent për këto çështje</p>
<p>Buxheti i vitit 2024 dhe parashkimi për vitet 2025-2026</p> <p>Takimi me Gratë e Komunës</p>	<p>1.Caktimi i një personi për të mirëmbajtur parkun “Isa Berisha” .</p>	<p><b>Hyrjete Isufi</b> – Mësimdhënëse</p>	<p>E pranuar</p>	<p>Komuna Hani i Elezit ka marrëveshje mirëkuptimi për mirëmbajtjen e hapësirave publike me kompaninë NPL Pastrimin</p>

	2. Tek mbikalimi i hekurudhës të bëhet një mbikalim për personat me aftësi të kufizuara dhe nënat me karroca	<b>Ibadete Kalisi</b> - Asambleiste	E pranuar	Kjo kërkesë është pranuar dhe do të implementohet përgjatë vitit 2024
Buxheti i vitit 2024 dhe parashkimi për vitet 2025-2026	1. Sa është i përfshirë OJQ Mjalti dhe OJQ-të tjera të përfshira në Planifikimet Buxhetore ?	<b>Muhamed Suma</b> – Kryeimam i Bashkësisë Islame	E pranuar	Kjo do të mvaret nga numri i shoqatave/OJQ-të që do të aplikojnë dhe me çfarë projektsh do të jenë aplikimet e të njejtave
	2. A parashikon Komuna të subvencionoj fermerët për dëmtimet që pësojnë nga të rreshurat, bletarët nga sulmet e ariut.	<b>Muhamed Suma</b> – Kryeimam i Bashkësisë Islame	E pranuar pjesërisht	Komuna nuk është kompetente për kompensime të tilla, këto ju takojnë Ministrive të Linjave, por mundemi të asistojmë në përgatitjen e kërkesave.
	3. A ka mundësi Komuna të dhuroj kontinier për disa fermerë?	<b>Muhamed Suma</b> – Kryeimam i Bashkësisë Islame	Nuk pranohet	Komuna ska mundësi të mbështesi fermerët me kontiniera
	4. Kërkesë për tu rritur subvencionimi i Shoqatës së Pensionistëve ose të rritet numri i	<b>Shefket Lusnjani</b> – Administrator i fshatit Gorancë	E pranuar	Komuna ka zhvilluar procedura për rehabilitimin e pensionerëve, ku është përfshirë edhe transporti dhe mundet të ofrojë sigurimin e transportit për ato pensioner të



	<p>pensionistëve të cilët shkojnë për rehabilitim.</p> <p>5. Rregullimi i rrugës Rezhancë – Tanas.</p> <p>6. Informatë për subvencionimin në Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport</p>	<p><b>Halim Ballazhi</b> - Qytetar</p> <p><b>Bunjamin Berisha</b> - Mësimdhënës</p>	<p>E pranuar</p> <p>E pranuar</p>	<p>cilët e financojnë rehabilitimin me mjete personale.</p> <p>Ndërtimi, rihapja dhe zgjerimi I rrugëve është projekt standard që implementohet çdo vit nëpër zona urbane dhe rurale</p> <p>Informacioni është dhënë në procesverbalin e dëgjimit</p>
<p>Buxheti i vitit 2024 dhe parashkimi për vitet 2025-2026</p> <p>Dëgjim buxhetor me Bizneset</p>	/	/	/	/
<p>Buxheti i vitit 2024 dhe parashkimi për vitet 2025-2026</p> <p>Dëgjimi Buxhetor në fshatin Gorancë</p>	<p>1. Ndërtimi i rrugës Bypass</p> <p>2. Rruga Krevenik – Gorancë</p>	<p><b>Shefket Lusnjani</b> – Administrator i fshatit Gorancë</p>	<p>E pranuar</p> <p>E pranuar</p>	<p>Ndërtimi, rihapja dhe zgjerimi I rrugëve është projekt standard që implementohet çdo vit nëpër zona urbane dhe rurale, disa projekte të rrugëve I dërgojmë për implementim edhe nëpër Ministri të ndryshme.</p> <p>Ndërtimi, rihapja dhe zgjerimi I rrugëve është projekt standard që implementohet</p>

				çdo vit nëpër zona urbane dhe rurale, disa projekte të rrugëve I dërgojmë për implementim edhe nëpër Ministri të ndryshme.
	3. Shtrimi me kubëza të rruga për të varrezat në Rezhancë,		E pranuar	Shtrimi me kubëza betoni rrugicat në zona urbane dhe rurale është projekt në vazhdimësi
	4. Vendosija e rrethojave të varrezat e Hunelëve,	<b>Hazbi Berisha</b> – banor i fshatit Gorancë	E pranuar	Do ta shqyrtojm mundësinë e kryerjes së kësaj kërkesë
	5. A ka projekt apo marrëveshje për mirëmbajtjen e rrugëve.	<b>Nusret Berisha</b> - banor i fshatit Gorancë	E pranuar	Komuna Hani i Elezit ka marrëveshje mirëkuptimi për mirëmbajtjen e autorrugëve lokale me kompaninë NPL Pastrimin
	6. Hapja e rrugës nga fshati Gorancë deri të varrezat e Dëshmorëve në fshati Pustenik.		E pranuar	Ndërtimi, rihapja dhe zgjerimi i rrugëve është projekt në vazhdimësi, cila rrugë do të implementohet mvaret nga kostoja si dhe mbështetja edhe nga Ministrinë e Linjës

Buxheti i vitit 2024 dhe parashkimi për vitet 2025-2026  Dëgjimi Buxhetor në fshatin Paldenicë	1. Ndërtimi i një trotuari te rruga “Udha e Shkronjave”	<b>Fatmir Dernjani</b> – banor i fshatit Paldenicë	E pranuar	Ky project ka hyrë në Planfikimin Buxhetor me implementim në vitin 2025
	2. Disa shtëpi nuk janë të lidhura me kanalizim		E pranuar	Projekti i kanalizimeve ka hyrë në planfikimin e buxhetit për vitin 2024
	3. Asfaltimi i rrugës “Nehat Curri”	<b>Tahir Curri</b> – banor i fshatit Dromjak	E pranuar	Ky projekt ka hyrë në listën e projekteve kapitale 2024-2026
	4. Zgjerimi i rrugës “Elham Curri”		E pranuar	Ky projekt ka hyrë në listën e projekteve kapitale 2024-2026
	5. Rregullimi i rrugës te vendi Kolorash		E pranuar	Ndërtimi, rihapja dhe zgjerimi i rrugëve është projekt në vazhdimësi, cila rrugë do të implementohet mvaret nga kostoja si dhe mbështetja edhe nga Ministrinë e Linjës
	6. Vendosja e koritës te prroi i Lakut	<b>Ahmet Krasniqi</b> – Drejtor shkolle	E pranuar	Do të shqyrtojmë mundësitë e realizimit të projektit qoft me kapacitete komunale ose bashkëfinancim me ndonjë Ministri/Organizatë etj.
Buxheti i vitit 2024 dhe parashkimi për vitet 2025-2026	1. Rregullimi i rrjetit të kanalizimit	<b>Sefedin Thaçi</b> – banor i fshatit Krivenik	E pranuar	Projekti i kanalizimeve ka hyrë në planfikimin e buxhetit për vitin 2024

Dëgjimi Buxhetor në fshatin Krivenik	2. Rihapja dhe zgjerimi i rrugës me zhavor deri te vendi i quajtur Mullit		E pranuar	Do të shqyrtojmë mundësitë e realizimit të projektit qoft me kapacitete komunale ose bashkëfinancim me ndonjë Ministri/Organizatë etj.
Buxheti i vitit 2024 dhe parashkimi për vitet 2025-2026  Dëgjimi Buxhetor në fshatin Seçishtë	1. Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor deri në vendin e quajtur Vorba.  2. Rezervuari i ujit në Sarasellë.  3. Hapja e bunarit te burimi.  4. Rihapja, zgjerimi dhe shtrimi me zhavor në vendin e quajtur Nën Breg.	<b>Mervet Kalisi</b> – banor i fshatit Seçishtë	E pranuar  E pranuar  Nuk pranohet  E pranuar	Ndërtimi, rihapja dhe zgjerimi i rrugëve është projekt në vazhdimësi, cila rrugë do të implementohet mvaret nga kostoja si dhe mbështetja edhe nga Ministrinë e Linjës  Projekti i propozuar ka hyrë në planifikimin e buxhetit për vitin 2024  Për shkak të mjeteve shumë të kufizuara kjo kërkesë do të shqyrtohet të realizohet gjatë viteve vijuese  Projekti i propozuar ka hyrë në planifikimin e buxhetit për vitin 2024

	<p>5. Shtrimi me kubëza betoni përreth rrugës së fshatit Seçishtës.</p>		E pranuar	Ndërtimi, rihapja dhe zgjerimi i rrugëve është projekt në vazhdimësi, cila rrugë do të implementohet mvaret nga kostoja si dhe mbështetja edhe nga Ministrinë e Linjës
	<p>6. Vendosja e shportave të mbeturinave rreth rrugës.</p>		E pranuar	Do të shqyrtojmë mundësinë e kompletimit të shportave të mbeturinave
	<p>7. Rregullimi i kanalit të ujitjes në vendin Lloka</p>		E pranuar	Ky projekt është realizuar përgjatë vitit aktual
	<p>8. Rregullimi i aneksit për këmbësor në Urën e Seçishtës</p>		E pranuar	Ky projekt ka hyrë në listen e projekteve kapitale me implementim në vitin 2025.